

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7831
E mërkurë, 10 korrik 2024
Çmimi 0.50 €

Në Uashington nis Samiti i NATO-s



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KONJUFCA: NËSE SERBIA NUK NDËSHKOHET, DO TA PËRSËRISË SULMIN NË BANJSKË



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka theksuar se Serbia mund ta përsërisë "agresionin terrorist" në Kosovë nëse nuk ndëshkohet për sulmin e vitit

të kaluar në Banjskë. "Si një nga shtetet që nuk e ka mbështetur sanksionimin e Rusisë për luftën pushtuese në Ukrainë dhe vazhdon të kultivojë bashkëpunim

ushtarak me Rusinë, Serbia duhet të shihet si rrezik jo vetëm në Kosovë, por për krejt paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor", ka thënë Konjufca

JAKUP KRASNIQIT IU HOQ KOLLARJA PARA SEANCËS, MINISTRJA HAXHIU I SHKRUAN KRYETARES SË SPECIALES: AKT ABSURD, MERRNI MASA F.6



HARADINAJ: QEVERIA AKTUALE PO E PAMUNDËSON ANËTARËSIMIN NË NATO F.6



AKTUALE



KRYEMINISTRI SLOVAK KTHEHET NË PUNË PAS ATENTATIT F.2

MASHTI PUBLIKON REZULTATET E TESTIT TË ARRITSHMËRISË, KALUESHMËRIA 52.1 % F.5

HAPET EDICIONI I 24-t I UNIVERSITETIT VEROR NDËRKOMBËTAR TË PRISHTINËS F.7

EKONOMI



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS: PËRFSHIRJA NË GOOGLE WALLET, VENDIM INDIVIDUAL I BANKAVE F.8

"PAGAT E ULËTA NUK NA MJAFTOJNË AS PËR BUKË", THONË PUNËTORËT TEKNIKË TË KUVENDIT TË KOSOVËS F.8

SPORT



HOLANDA E ANGLIA NË KËRKIM TË FINALES F.10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Turqia nis në hapësirë satelitin e parë

ANKARA, 9 KORRIK - Turqia nisi në hapësirë satelitin e vet të parë të komunikimeve, Turksat 6A. Një raketë e kompanisë SapceX e barti atë nga Stacioni i Forcave Hapësinore Cape Canaveral në Floridë të ShBA-së. Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan tha se nisja e këtij sateliti në hapësirë shënon një "faze të re" për Turqinë në prodhimin e satelitëve.

"Si Turqi ne kemi prodhuar më shumë se 81 % të nënsistemeve, stacioneve tokësore satelitore dhe softuerëve në projektin 6A, i cili ka një rëndësi të madhe për të ardhmen e vendit tonë në hapësirë, me burime kombëtare", tha Erdogan. Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës i Turqisë, Abdulkadir Uraloglu, tha se sinjali i parë nga Turksat 6A

është marrë 67 minuta pas nisjes së tij, ashtu siç ka qenë planifikuar. "Ne i kemi sjellë komunikimet tona, transmetimet tona televizive në një nivel më të sigurt dhe më të mirë", tha ai, duke shtuar se Turksat 6A tani do t'i mundësojë Turqisë të arrijë edhe në Indi, Indonezi, Malajzi dhe Tajlandë. Uraloglu tha se Turksat 6A është rezultat i një



përpjekjeje 10-vjeçare për të prodhuar satelit vendor. Me këtë hap, Turqia është bërë një nga 11 vendet që e kanë arritur këtë, tha Uraloglu.

Sarajeva përcjell eshtrat e 14 viktimave të gjenocidit në Srebrenicë

SARAJEVË, 9 KORRIK - Një autokolonë me eshtrat e 14 viktimave të gjenocidit në Srebrenicë parakaloi të martën në Sarajevë, në prag të shënimit të përvjetorit të 29-të të masakrës. Rugës për në Qendrën Përkujtimore Potoçari, ku edhe do të varrosen më 11 korrik, autokolona u ndal për pak kohë para ndërtesës së Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës në qendër të qytetit. Eshtrat e viktimave që do të varrosen u identifikuan gjatë vitit të kaluar.

Viktima më e re është Beriz (Omer) Mujiq, i cili në kohën kur ndodhi gjenocidi më 1995, ishte 17 vjeç, ndërsa viktima më e vjetër është Hamed Salliç, atëkohë 68 vjeç. Në Srebrenicë dhe zonat përreth, forcat serbe të Bosnjës vranë më shumë se 8 300 boshnjakë në korrik të vitit 1995. Në atë kohë Srebrenica ishte zonë e mbrojtur nga Kombet e Bashkuara. Me një vendim në vitin 2007, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë e karakterizoi krimin në Srebrenicë si gjenocid.

Në maj të këtij viti Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e shpalli 11 korrikun Ditë Ndërkombëtare të Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë. Deri më tani, mbi 6 650 viktima të gjenocidit janë varrosur në Qendrën Përkujtimore Potoçari. Më shumë se 1 000 persona të zhdukur janë ende në kërkim. Gjykata të ndryshme kanë dënuar deri tash më shumë se 50 persona, me më shumë se 700 vjet burg, për gjenocid dhe krime të tjera në Srebrenicë.



Bideni dënon "brutalitetin rus" në Ukrainë



UASHINGTON, 9 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, e dënoi valën e sulmeve raketore ruse të hënën në Ukrainë, ku mbetën të vrarë dhjetëra njerëz. Bideni tha se ajo është një "rikujtuese e tmerrshme e brutalitetit të Rusisë" dhe u zotua se do ta forcojë mbrojtjen ajrore të Kievit. Së paku 37 njerëz u vranë të hënën në disa qytete të Ukrainës, përfshirë 21 në kryeqytetin Kiev. Shënjestër e sulmeve ishte edhe një spital për fëmijë, ku mbetën të vrarë dy punonjës. Bideni tha se përforcimet e mëtejshme për mbrojtjen ajrore të Ukrainës do të shpallen gjatë Samitit të NATO-s që nis punimet

sot në Uashington. Udhëheqës nga 32 shtetet anëtare të NATO-s, vendet e tyre partnere dhe BE-ja, mblidhen për ta shënuar 75-vjetorin e aleancës. Pritet që edhe presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, të jetë i pranishëm. "Unë do të takohem me presidentin Zelensky për ta bërë të qartë se mbështetja jonë për Ukrainën është e palëkundur", tha Bideni. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do të takohet po sot për të diskutuar për sulmet ruse në Ukrainë. Kryetari i Kievit, Vitali Klitschko, e shpalli 9 korrikun ditë zie pas sulmeve vdekjeprurëse në kryeqytet.

Kryeministri slovak kthehet në punë pas atentatit

BRATISLAVË, 9 KORRIK - Kryeministri i Sllovakisë, Robert Fico, tha se është rikthyer në punë të martën, gati dy muaj pasi u plagos nga një person i armatosur. Fico, 59 vjeç, u qëllua nga afër më 15 maj, në një qytet të Sllovakisë qendrore dhe iu nënshtrua dy operacioneve të gjata. Personi i armatosur, i identifikuar nga mediet sllovaqe si Juraj Cintula, 71 vjeç, është në paraburgim në

pritje të gjyqimit. Mediet sllovaqe shkruan se Fico, i cili shpesh kritikohet nga Bashkimi Evropian për shkak të prirjeve nacionaliste, shkoi në mbledhjen e kabinetit të tij përmes një tuneli për t'i shmangur gazetarët. "Të nderuara media liberale progresive dhe opozitë, kërkoj falje që mbijetova, por jam kthyer", shkroi Fico në "Facebook", duke postuar edhe një

fotografi nga zyra. Kur Fico ka marrë detyrën vjeshtë e kaluar, Sllovakia ka refuzuar ta vazhdojë ndihmën ushtarake për Ukrainën, e cila lufton kundër pushtimit rus që nga viti 2022. Vetë Fico i ka mbështetur bisedimet e paqes me Rusinë. Ai ka dalë nga spitali më 31 maj, ndërsa paraqitjen e parë publike e ka bërë në një ceremoni pranë Bratislavës të premten e kaluar.



Digjen dy automjete në veri, dëmtohet edhe një veturë

PRISHTINË, 9 KORRIK - Dy furgonë janë djegur në orët e para të së martës në Mitrovicë të Veriut, ndërsa zjarri që i përfshiu ata dëmtoi edhe një veturë udhëtarësh.

Zjarri ka të ngjarë të ketë qenë i qëllimshëm, tha për Radion Evropë e Lirë zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për Rajonin Verior, Veton Elshani.

Ai nuk dha detaje të tjera rreth rastit, përveçse nuk ka të dyshuar dhe se hetimet janë duke u zhvilluar.

REL-i mori vesh se pronarët e furgonëve janë shqiptarë, të

cilët kanë biznese me shumicë në veri të Mitrovicës, ndërsa automjeti i dëmtuar i pasagjerëve është në pronësi të një serbi, D. P.

Zjarrit që përfshiu furgonët, i paraprinë tri shpërthime.

Në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe - kanë ndodhur disa incidente të ngjashme këtë vit.

Në fillim të qershorit janë djegur dy makina në vendin e njëjtë ku janë djegur edhe furgonët e fundit, ndërsa në fillim të prillit një pjesëtar i policisë kufitare të Kosovës i është djegur, po

ashtu, vetura.

Në fillim të muajit mars është djegur edhe një restorant në pronësi të Natasha Tomaniqit, ish-zëvendëskryetare e komunës së Zveçanit. Ajo dhe autoritetet lokale kanë thënë se dyshohet se zjarri është shkaktuar qëllimisht.

Në fund të marsit, ndërkaq, është djegur një objekt në pronësi të Nenad Radosavleviqit, ish-drejtor i Administratës për Sport, Rini dhe Kulturë në Komunën e Leposaviqit.

Radosavleviq ka thënë për REL-



in atëkohë se beson se motivi për zjarrvënien ka qenë i natyrës politike. Gjatë vitit 2023 dhe në fund të vitit 2022, kur ka qenë në proces

riregjistrimi i automjeteve me targa të Kosovës në veri, janë djegur disa vetura me targa RKS (Republika e Kosovës) në atë zonë.

Konjufca: Nëse Serbia nuk ndëshkohet, do ta përsërisë sulmin në Banjskë



PRISHTINË, 9 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, tha se Serbia mund ta përsërisë "agresionin terrorist" në Kosovë nëse nuk ndëshkohet për sulmin e vitit të kaluar në Banjskë. Në këtë fshat në veri të Kosovës, grupe të armatosura serbësh sulmuan policinë e Kosovës më 24 shtator dhe vranë një polic. Kosova e bëri përgjegjëse Serbinë për sulmin, por ajo e mohoi. "Si një nga shtetet që nuk e ka mbështetur sanksionimin e Rusisë për luftën

pushtuese në Ukrainë dhe vazhdon të kultivojë bashkëpunim ushtarak me Rusinë, Serbia duhet të shihet si rrezik jo vetëm në Kosovë, por për krejt paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Kemi folur edhe për sigurinë në Kosovë dhe rreziqet që po përballemi për shkak të pretendimeve territoriale të Serbisë. Po qe se Serbia lihet e pandëshkuar lidhur me agresionin terrorist në Banjskë që u krye në shtator të vitit të kaluar, Serbia ka

për ta përsëritur këtë skenar, por me përmasa më të mëdha", tha Konjufca.

Konjufca, edhe në fillim të këtij muaji, ka thënë se në Serbi po përgatiten për sulm ose provokim eventuale në Kosovë. Ai i bëri komentet e fundit në një konferencë të përbashkët për medie me presidentin e Këshillit Kombëtar të Zvicrës, Eric Nussbaumer, të martën në Prishtinë.

Nussbaumer tha se Zvicra është

mbështetëse e vazhdueshme e Kosovës.

Ai tha se vendi i tij është i shqetësuar për tensionet në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe - dhe i bëri thirrje si Kosovës, ashtu edhe Serbisë, që t'i adresojnë ato dhe ta parandalojnë përkallëzimin e situatës.

Përgjegjësinë për sulmin në Banjskë e ka marrë Millan Radoiçiq, ish-nënkryetar i partisë më të madhe të serbëve të Kosovës, Lista Serbe.

Radoiçiqi besohet se është i lirë në

Serbi.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kërkuar dorëzimin e tij si kusht për vazhdimin e dialogut në nivel të lartë me Serbinë, me qëllim normalizimin e marrëdhënieve.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, nuk e ka pranuar këtë kusht. Ndihmëssekretari amerikan i Shtetit, James O'Brien, ka thënë në fund të muajit të kaluar se Serbia ka premtuar se Radoiçiqi do të përballlet me ligjin në lidhje me ngjarjet në Banjskë.

Më 16 korrik Specialja shpall aktgjykimin ndaj Pjetër Shalës

PRISHTINË, 9 KORRIK - Më 16 korrik do të shpallet aktgjykimimi ndaj ish-pjesëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Pjetër Shala, i njohur si komandant "Ujku".

Në njoftimin e bërë për medie nga Dhomat e Specializuara thuhet se seanca do të nisë në orën 14:00. "Trupi Gjyqësor i caktoi mbajtjen e seancës së shqiptimit të Aktgjykimimit në çështjen gjyqësore Pjetër

Shala për 16 korrik 2024 në orën 14:00", thuhet në njoftim.

Pjetër Shala ndodhet në qendrën e paraburgimit në Hagë që prej marsit të vitit 2021. Sipas Speciales, "krimet për të cilat akuzohet z. Shala u kryen përafërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999 kundër personave që u mbajtën të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës

(Shqipëri), që pretendohet se përdorej prej Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".

Pjetër Shala u arrestua më 16 mars 2021 nga autoritetet belge dhe u transferua në Hagë më 15 prill të atij viti, në bazë të një kërkesë për bashkëpunim në zbatimin e fletarrestimit dhe urdhrimit për transferim lëshuar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës.





Në Uashington nis Samiti i NATO-s

WASHINGTON, 9 KORRIK - Udhëheqësit e aleancës ushtarake të Perëndimit janë mbledhur të martën në Uashington.

Samiti vjetor i NATO-s, që do të zgjasë deri më 11 korrik, përkon me 75-vjetorin e themelimit të saj dhe zhvillohet derisa lufta në Ukrainë vazhdon.

Sipas sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, samiti i Uashingtonit do të fokusohet në tri tema kryesore.

E para është forcimi i mbrojtjes. Që nga aneksimi i Krimesë nga Rusia në vitin 2014, prioriteti kryesor i NATO-s ka qenë forcimi i mbrojtjes për ta shmangur luftën. Kjo agjendë është transformuar dy vjet më parë, pasi Rusia ka nisur pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës.

NATO-ja ka rënë dakord për një koncept të ri strategjik në samitin e Madridit, që bazohet në përpjekjet ekzistuese për forcimin e mbrojtjes.

Një vit më vonë, në Vilnius, aleatët janë pajtuar për plane të reja për

të përmbushur atë vizion.

E Samiti i Uashingtonit do të fokusohet tani në zbatimin e këtyre planeve, për ta penguar sulmin e armatosur dhe për ta mbrojtur aleancën.

Që nga Madridi, aleatët e NATO-s kanë bërë përparim në zbatim - kanë rritur shpenzimet e mbrojtjes, kanë shtuar forcat e gatishmërisë së lartë, kanë modernizuar komandën dhe kontrollin, kanë transformuar ushtrimet e mbrojtjes kolektive dhe kanë integruar me sukses aleatë të rinj: Finlandën dhe Suedinë.

Megjithatë, pyetja është nëse NATO-ja është gati të luftojë dhe në atë mënyrë ta pengojë një luftë të zgjatur, si ajo në Ukrainë? Për këtë, është e rëndësishme të forcohet "shtylla evropiane" e NATO-s.

Tema e dytë e samitit do të jetë mbështetja e përpjekjeve të Ukrainës për t'u mbrojtur kundër pushtimit rus.

Ukraina do të jetë "në krye të

agjendës sonë dhe ne jemi në rrugën e duhur për një samit të suksesshëm", ka thënë Stoltenbergu.

Por, gjasat që Ukraina, gjatë Samitit në Uashington, të marrë ftesë zyrtare për t'u bashkuar me aleancën e NATO-s, janë gati joekzistente.

Paketa e NATO-s për Ukrainën do të përbëhet nga tri pjesë: gjuha, koordinimi dhe ndihma.

Gjuha në lidhje me anëtarësimin e Ukrainës do të duhet të ndërtohet mbi zotimin në Vilnius se "e ardhmja e Ukrainës është në NATO".

Zyrtarë të lartë amerikanë i janë referuar paketës së Uashingtonit si një "urë e fortë" drejt anëtarësimit, që është "e ndriçuar mirë, e shkurtër, e drejtë, e papenguar".

Por, negociatat për formulimin e saktë të komunikatës së samitit ka të ngjarë të vazhdojnë deri në minutën e fundit.

Dhe, tema e tretë e samitit do të jetë forcimi i partneriteteve

globale të NATO-s.

Aleatët e NATO-s janë duke e kuptuar gjithnjë e më shumë se sfidat me të cilat përballen, janë të ndërthurura me rajone të tjera.

Për shembull, 40 për qind e tregtisë së Evropës kalon përmes Detit të Kinës Jugore, ndërsa luftën e Rusisë në Ukrainë e ka mbështetur importimi i municioneve nga Koreja e Veriut dhe mallrat kineze me përdorim të dyfishtë.

Siç ka konfirmuar ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Euroaziatike, Jim O'Brien, partneriteti në Indo-Paqësor do të jetë një temë kryesore e Samitit të Uashingtonit.

Katër partnerët e NATO-s në Indo-Paqësor - Australia, Japonia, Zelanda e Re dhe Koreja e Jugut - janë tashmë pjesëmarrës të rregullt në samitet e aleatëve.

Në Uashington do të jenë edhe përfaqësuesit e të gjithë partnerëve të NATO-s, përfshirë Bashkimin Evropian.

Kosova, po ashtu, do të përfshihet për herë të parë në një ngjarje në kuadër të samitit.

Presidentja Vjosa Osmani do të marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Samiti do të jetë i fundit për Stoltenbergun, pasi në vjeshtë do t'ia dorëzojë detyrën kryeministrit aktual holandez, Mark Rutte. Në të kaluarën Rutte ka mbështetur fuqishëm idenë se Evropa duhet t'i forcojë aftësitë e saj të mbrojtjes dhe inteligjencës, gjithashtu ka pranuar se furnizimet e ShBA-së janë kritike për ta arritur këtë qëllim.

Përvoja e Ruttes si kryeministër i Holandës për gati 14 vjet, duke udhëhequr qeveri të ndryshme koalicioni, do ta ndihmojë atë ta përballojë sfidën e mbajtjes bashkë të 32 aleatëve të NATO-s. Por, sfida më e madhe për të dhe NATO-n do të jetë përshtatja e aleancës përballë një Kremlini gjithnjë e më agresiv.

Haradinaj: Qeveria aktuale po e pamundëson anëtarësimin në NATO

Prishtinë, 9 korrik - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se i mrekullueshëm do të ishte lajmi sikur Kosova të diskutonte për anëtarësimin e saj në NATO por, sipas tij, politikat e liderit aktual të Kosovës kanë pamundësuar një gjë

të tillë. "Pjesëmarrja e Kosovës në çfarëdo forumi që ndërlidhet me NATO-n, përfshirë edhe ftesën e presidentes që të jetë pjesë e aktivitetit për gratë, paqen dhe sigurinë, në kuadër të Samitit të NATO-s, është nder për vendin, për çka u jemi mirënjohës aleatëve! Udhëheqja e sotme e

Kosovës apo cilado që vjen pas saj, duhet ta kuptojnë që detyrë mbi detyrat mbetet anëtarësimi në NATO. Ata që nuk e mbështesin këtë synim shtetëror të Kosovës, jo vetëm që janë shkurt-pamës por nuk e dinë pse i mbajnë postet që i kanë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



Lajçaku për takimin e fundit me Bislmin dhe Petkoviqin: Fatkeqësisht, nuk arritëm përparim për zbatimin e Marrëveshjes

PRISHTINË, 9 KORRIK - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, duke e bërë një rezumë të punës së tij javore, ka folur sërish për takimin që ka pasur javën e kaluar me kryenegociatorët Besnik Bislmi dhe Petar Petkoviq. Ai ka thënë se pas më shumë se shtatë orësh diskutimesh intensive kanë rënë dakord për hapat e ardhshëm konkretë për disa çështje praktike, por jo edhe për

zbatimin e Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit. “Në Bruksel prita kryenegociatorët e Kosovës dhe Serbisë... Pas më shumë se shtatë orësh diskutimesh intensive, ne ramë dakord për hapat e ardhshëm konkretë për disa çështje praktike. Fatkeqësisht, nuk arritëm përparim në tablonë e madhe - zbatimin e Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit”, ka shkruar Lajçaku në “Facebook”.



O'Brien: Veriu i Kosovës, në mesin e rreziqeve për sigurinë në Ballkan



PRISHTINË, 9 KORRIK - Ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Euroaziatike, James O'Brien, i tha agjencisë serbe të lajmeve “Tanjug” se veriu i Kosovës dhe kërcënimet për shkëputjen e një pjese të Bosnjë-Hercegovinës, janë rreziqet kryesore për sigurinë në Ballkanin Perëndimor. Por, theksoi ai, forcat paqeruajtëse të KFOR-it në Kosovë dhe ato të EUFOR-it në Bosnjë janë të gatshme “t’i

pengojnë grupet e vogla lokale që të shkaktojnë dhunë”. “Jam i inkurajuar që ka pasur bashkëpunim të mirë me autoritetet serbe, me autoritetet e Kosovës, në përpjekje për t’i trajtuar rreziqet e dhunës dhe të rritjes së përplasjeve në veri të Kosovës. Mendoj se me këtë kemi një shans për procesin politik, që është dialogu [i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian], plani [evropian] i rritjes ekonomike

dhe gjërat e tjera për t’i trajtuar shkaqet e dhunës”, tha O'Brien.

I pyetur pse ShBA-ja mbështeti një tranzicion të Forcës së Sigurisë së Kosovës sipas standardeve të NATO-s dhe pse Prishtinës iu lejua të blejë dronë kur, “sipas Rezolutës 1244, KFOR-i është e vetmja forcë e armatosur e lejuar në Kosovë”, O'Brien tha se rezoluta vendosi “një proces politik për të diskutuar të ardhmen e Kosovës”. “Ai

proces çoi në pavarësinë e Kosovës. Kosova ka të drejtë ta mbrojë territorin e saj”, tha O'Brien, duke nënvizuar se ajo “po e bën këtë në një proces transparent dhe në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, si një mënyrë për ta siguruar mbrojtjen e saj, por pa kërcënuar fqinjët e saj”. “Mendoj se, në përgjithësi, është një lëvizje drejt qëndrueshmërisë në rajon. Ne do të vazhdojmë ta

mbështesim”, tha diplomati amerikan.

Ai ritheksoi, po ashtu, mbështetjen për bisedimet Kosovë - Serbi dhe themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. “Janë rreth 400 asociacione të komunave në të gjithë Evropën dhe ne mendojmë se ky do të ishte një i tillë”, tha ai, duke nënvizuar se bisedimet janë rruga e Kosovës dhe Serbisë drejt integriteteve evropiane.

MASHTI publikon rezultatet e Testit të Arritshmërisë, kalueshmëria 52.1 %

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka publikuar rezultatet e Testit të Arritshmërisë, të cilit i janë nënshtruar mbi 22 mijë nxënës të klasave të nënta. Këtë vit kalueshmëria në testin e Arritshmërisë në gjithë vendin është 52.1 %.

Arritshmëria në gjuhën shqipe është 56.9 %, në gjuhën angleze 69.3 %, në Histori 57.5 %, në Gjeografi 56.8 %, në Matematikë 43.1 %, në Informatikë 47.4 %, në Fizikë 46.5 %, në Kimi 43.4 % dhe në Biologji 48.8 %.

Testi i Arritshmërisë është organizuar në 183 qendra të

testimit, ku nxënësit janë sistemuar në 1 658 salla të testimit.

MASHTI falënderon të gjithë ata që janë përfshirë në procesin e mbajtjes së Testit të Arritshmërisë për kontributin dhe bashkëpunimin e tyre. Afati i ankesave është deri më 12 korrik.



Mbi 132 mijë euro për promovimin e shëndetit mendor, luftimin e tuberkulozit dhe HIV-it

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar kontratat me dhjetë organizata joqeveritare (OJQ) që kanë përfituar nga mbështetja financiare sipas thirrjes publike "Promovimi i Shëndetit Mendor, Promovimi dhe Parandalimi i Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB, si dhe fuqizimi i të rinjve për një jetë të

shëndetshme". OJQ-të do të zhvillojnë aktivitete parandaluese, promovuese, edukative dhe avokuese, sipas objektivave specifike, si promovimi i shëndetit mendor dhe parandalimi i çrregullimeve mendore; mbajtja e prevalencës së ulët të HIV-it në mesin e popullatave kyçe dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së personave të prekur

nga HIV-i në Kosovë; forcimi dhe avokimi për sëmundjen e Tuberkulozit (TB) në komunitet; fuqizimi i të rinjve me shkathtësi jetësore për një jetë të suksesshme dhe të mirëqenë përmes edukimit joformal dhe aktiviteteve vetëdijësuese. Shuma e përgjithshme e mjeteve të ndara për zbatimin e projekteve nga OJQ-të është 132 975.08 euro.



Jakup Krasniqit iu hoq kollarja para seancës, ministrja Haxhiu i shkruan kryetares së Speciales: Akt absurd, merrni masa


PRISHTINË, 9 KORRIK - Në seancën e së hënës të Dhomave të Specializuara në Hagë, ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, iu hoq kravata me simbole kombëtare para se të futej në sallën e gjyqit. Për këtë rast ka reaguar ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e cila në një letër ka kërkuar nga kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës, Ekaterina Trendafilova, të marrë veprime për ta adresuar çështjen e heqjes së kollares së Jakup Krasniqit para seancës gjyqësore të së hënës në Speciale. Haxhiu ka shkruar se ky veprim i Speciales është akt absurd. "Telegrafi" ka siguruar letrën e ministres Haxhiu drejtuar kryetares së Dhomave të Specializuara të Kosovës,

Trendafilova. "Përmes kësaj letre, ju shkruaj lidhur me situatën e fundit që ka ndodhur në seancën gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës. Sipas informatave që kemi pranuar, para se z. Jakup Krasniqi të hynte në sallën ku mbahen seancat gjyqësore, iu është larguar kollarja që mbante veshur, pa asnjë arsye dhe pa asnjë justifikim. Madje kur kjo është ngritur si shqetësim nga avokatja, e njëjta ka marrë përgjigjen nga gjyqtari Charles Smith se ai nuk ka informacione dhe që do të interesohet për këtë. Ky veprim ka shkaktuar shqetësim të thellë dhe indinjatë në opinionin publik të Kosovës", thuhet në letrën e Haxhiut drejtuar kryetares së Dhomave të Specializuara.



Prishtina bëhet me Sektor për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e UÇK-së


PRISHTINË, 9 KORRIK - Komuna e Prishtinës ka formuar Sektorin për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e UÇK-së, i cili do të udhëhiqet nga Sylë Vitia. Ky i fundit në "Facebook" ka thënë se Prishtina është komuna e vetme në Kosovë që formon një sektor të tillë. "Kam kënaqësinë t'ju njoftoj se nga sot Sektori për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e UÇK-së në komunën e Prishtinës fillon punën. SÇKDL e UÇK-së është në kuadër të kabinetit të kryetarit të komunës së Prishtinës. Përmes këtij sektori do të përfaqësohen, promovohen dhe realizohen të drejtat e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së të përcaktuara në ligj. Vlen të theksohet se komuna e Prishtinës është komuna e parë dhe e vetme në



Republikën e Kosovës e cila ka themeluar sektor të UÇK-së në kuadër të kabinetit të kryetarit, dhe kjo u bë e mundur falë kryetarit Përparim Rama të cilin e falënderoj", ka shkruar Vitia.

Mbi 1 300 raste të dhunës në familje u bartën për trajtim nga 2023-a

PRISHTINË, 9 KORRIK - Lëvizja FOL ka njoftuar se në vitin 2023 janë regjistruar 2 684 raste të dhunës në familje, prej të cilave 1 393 janë zgjidhur e 1 291 janë bartur për t'u trajtuar sivjet. Hulumtuesja e Lëvizjes FOL, Albana Hasani, ka thënë se raporti është bazuar në të dhënat e Prokurorisë. Sipas saj, bartja e lëndëve vazhdon të mbetet sfiduese për organet e sistemit të drejtësisë. Në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës në vitin 2023 ishin bartur 1 887 lëndë të dhunës në familje nga vitet paraprake, përkatesisht 70 për qind e lëndëve që kanë qenë punë në vitin 2023. "Ndërsa në shtatë prokuroritë themelore, në vitin 2023 ishin bartur gjithsej 1 381 lëndë të dhunës në familje nga



vitet paraprake apo 32 për qind të të gjitha lëndëve në punë. Norma mesatare e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në të gjitha gjykatat themelore gjatë vitit 2023 ishte 175 për qind, që nënkupton se numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe ishte dukshëm më i lartë se numri i lëndëve të reja të krijuara", ka thënë Hasani.

Nis ndërtimi i shkollës në lagjen "Kalabria"

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ka nisur ndërtimi i shkollës moderne me mbi 6500 metra katrorë në lagjen "Kalabria" në Prishtinë. Kryetari i komunës, Përparim Rama, ka thënë se kjo shkollë do të ofrojë kushte të nivelit evropian për arsimtarët dhe fëmijët tanë të dashur. "Klasa

mësimore, laboratorë të shumtë, sallë të edukatës fizike e pajisje digjitale që do t'i bëjnë fëmijët tanë të arsimohen ashtu siç e meritojnë. Me përfundimin e kësaj shkolle, rreth 1000 fëmijë të lagjes Kalabria nuk do të humbin kohë për udhëtim në shkollë të lagjeve

të tjera dhe telashet e prindërve për t'i bartur fëmijët e tyre do të marrin fund. Kjo do të reduktojë dukshëm komunikacionin në kryeqytet. Vazhdojmë tutje me shndërrimin e Kalabrisë në lagje moderne dhe transformimin e kryeqytetit", ka thënë Rama.



Anulohet konkursi për rreshter në Policinë e Kosovës për shkak të parregullsive

PRISHTINË, 9 KORRIK - Policia e Kosovës ka marrë vendim për anulimin e konkursit për gradim në gradën rreshter të shpallur më 12.02.2024. Ky vendim erdhi pasi Inspektorati Policor i Kosovës ka gjetur dobësi në procesin e gradimit për rreshter. "Policia e Kosovës (PK), bazuar në udhëzimin administrativ për procedurën e gradimit për zyrtarë policorë, procedurën e standardeve të operimit, analizën e nevojave për personel të graduar sipas strukturës organizative dhe listës së personelit të autorizuar, sipas së cilës janë identifikuar mbi 350 pozita të lira për gradën rreshter, pas një periudhe mbi 11 vjet, me datën 12.02.2024 kishte shpallur procesin e gradimit për gradën rreshter, personel kyç për mbikëqyrje të vijës së parë dhe shërbimit sa më efektiv ndaj qytetarëve. Lidhur me këtë konkurs, Policia e Kosovës ishte angazhuar në përgatitjen dhe mbarëvajtjen e tërë procesit, duke angazhuar personel të mjaftueshëm si dhe duke caktuar komisionet mbikëqyrëse të të gjitha fazave të procesit të gradimit për gradën rreshter", ka njoftuar policia.

Sipas këtij njoftimi, edhe pse i tërë procesi, përfshirë testimin me shkrim, ishte mirë i përgatitur dhe i organizuar, megjithatë, pas shprehjes së disa pakënaqësive nga një numër i kandidatëve në këtë proces, Policia e Kosovës, duke u bazuar në parimet e transparencës, etikës, vlerave themelore, integritetit profesional dhe besueshmërisë, ka angazhuar stafin policor në analizimin e procesit, gjithashtu është përfshirë edhe Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) i cili ka bërë një inspektim të jashtëzakonshëm të këtij procesi. "Bazuar në të gjeturat e stafit policor të angazhuar për analizim të procesit si dhe raportit të inspektimit të IPK-së, është vlerësuar se procesi ka qenë në përgjithësi i rregullt dhe mirë i organizuar, përjashtimisht disa procedurave dhe çështjeve teknike e administrative, për të cilat IPK-ja ka dhënë rekomandimet e saja. Andaj, me qëllim të eliminimit të të gjitha paqartësive dhe ruajtjes së kredibilitetit të procesit të cilat mund të zbehin imazhin e Policisë së Kosovës, si dhe bazuar në rekomandimet e IPK-së,



Policia e Kosovës merr vendim për anulimin e konkursit për gradim në gradën rreshter të shpallur me 12.02.2024", theksohet në njoftimin e PK-së. Policia e Kosovës ka njoftuar tutje se, bazuar në të gjeturat dhe rekomandimet e IPK-së, pas rishikimit të procedurave dhe implementimit të ndryshimeve

dhe rekomandimeve të IPK-së, do të fillojë të gjitha përgatitjet e nevojshme administrative dhe logjistike, që procesi i gradimit për rreshter të vazhdohet sa më parë që të jetë e mundur. "Policia e Kosovës është organizatë transparente, llogaridhënëse dhe çdo gjë që mund të dëmtojë reputacionin apo të krijojë

mosbesim të policëve e të publikut, do të punojë që ta ruajë dhe ta ngritë edhe më tej besueshmërinë e zyrtarëve të saj dhe publikut, duke ofruar transparencë, monitorim të procesit nga partnerë të jashtëm dhe mbikëqyrje të të gjitha proceseve", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Hapet edicioni i 24-t i Universitetit Veror Ndërkombëtar të Prishtinës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 KORRIK - Universiteti i Prishtinës ka hapur zyrtarisht edicionin e 24-t të Universitetit Ndërkombëtar Veror të Prishtinës (PISU 24) me një ceremoni madhështore para ndërtesës së Rektoratit të Universitetit të Prishtinës.

Ngjarja shënon fillimin e dy javëve të mbushura me 28 kurse të ndryshme akademike, shkëmbime kulturore dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Ceremonia filloi me fjalën përshëndetëse nga rektori i UP-së, prof. Qerim Qerimi, i cili theksoi rëndësinë e universitetit veror në nxitjen e lidhjeve globale dhe zgjerimin e përvojave arsimore. "Në Universitetin e Prishtinës ne e kuptojmë se dija është e pafund dhe ajo zhvillohet me çdo moment që kalon. Prandaj, jemi kërenarë që të ndajmë me ju se kurset që ofrojmë do të lehtësohen nga profesorë që janë autoritete të njohura ndërkombëtare dhe ndihmohen nga literatura bashkëkohore, duke ngritur përvojën tuaj të mësimin në një standard ndërkombëtar të vërtetë. Universiteti ynë veror nuk është vetëm një ngjarje akademike. Është dëshmi për përpjekjen e vazhdueshme të universitetit tonë, për ta udhëhequr vendin dhe Evropën Juglindore në ofrimin e



mundësive të shkëlqyera të arsimit të lartë. Është një platformë ku ne festojmë fuqinë fascinuese të mësimin, gëzimin e shkëmbimit dhe vlerën e perspektivave të ndryshme. Ne besojmë me të vërtetë se studentët tanë, pra ju, nuk jeni vetëm e ardhmja e këtij rajoni, por katalizatorë të ndryshimit global", ka thënë rektori Qerimi.

E pranishme në hapje të edicionit të 24-t ishte edhe zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Liza Gashi, e cila, në fjalën e saj, ka

theksuar rëndësinë e arsimit ndërkombëtar dhe rolin e UVP-së në promovimin e Kosovës në skenën globale. "Kjo ngjarje është një dëshmi e përkushtimit dhe vizionit të Universitetit të Prishtinës. Ajo ofron një platformë unike për studentët që të fitojnë perspektiva ndërkombëtare dhe të ndërtojnë rrjete të qëndrueshme", vuri në dukje Gashi.

Në këtë aktivitet, Jehona Lushaku-Sadriu, nënkryetarja e Prishtinës, ka shprehur entuziazmin e saj për aktivitetet e pasura akademike

dhe kulturore që PISU sjell në qytet. "Prishtina ndihet e privilegjuar që është vendi mikpritës i një ngjarjeje të tillë të rëndësishme. Ne me padurim presim t'i mirëpresim të gjithë pjesëmarrësit dhe ta tregojmë trashëgiminë tonë të pasur dhe frymën e gjallë të qytetit tonë", ka deklaruar Lushaku.

Kuarteti i njohur Amati i Fakultetit të Arteve solli një performancë muzikore emocionuese, duke interpretuar një serë pjesësh të mahnitshme.

Anëtarët e Kuartetit, duke

përfshirë Fjollë Koxhën në violinë 1, Eliona Raqin në violinë 2, Alkesta Glogjanin në violonçel, impresionuan audiencën me aftësitë e tyre muzikore, duke krijuar një përvojë të jashtëzakonshme.

Në këtë ngjarje morën pjesë zyrtarë qeveritarë nga ministria dhe komuna, menaxhmenti i universitetit, komiteti drejtues, pjesëmarrësit të PISU-së, profesorë dhe studentë, ndërkombëtarë dhe vendorë.

Të pranishmit shijuan një përzgjedhje të këndshme ushqimesh dhe pije freskuese, duke nxitur një atmosferë shoqërie dhe festimi.

Universiteti Veror Ndërkombëtar i Prishtinës 2024 premton një program mjaft interesant prej 28 kurshesh, të ligjëruar nga profesorë të njohur ndërkombëtarë dhe akademikë vendas, duke ofruar një kombinim të ekspertizës globale dhe njohurive rajonale.

Me një agjendë të mbushur me sesione akademike, aktivitete kulturore dhe ngjarje të rjetëzimit, PISU synon të krijojë një përvojë arsimore transformuese për të gjithë pjesëmarrësit e saj.

Universiteti i Prishtinës me padurim pret një PISU 2024 të suksesshëm dhe frymëzues, duke vazhduar traditën e tij të shkëlqimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

"Pagat e ulëta nuk na mjaftojnë as për bukë", thonë punëtorët teknikë të Kuvendit të Kosovës

PRISHTINË, 9 KORRIK - Punëtorët teknikë të Kuvendit të Kosovës kanë protestuar të martën para Kuvendit për shkak të pagave të ulëta. "Kemi punuar si skllevër. Mjaftë më! Nuk po mund t'ia dalim", "Nuk mund të punojmë për 275 euro kur duhet të udhëtojmë e të paguajmë ushqim". Këto ishin disa nga ankesat e punëtorëve teknikë të Kuvendit të cilët po kërkojnë që paga nga 275 euro të rritet në 500 euro.

Për pagën e ulët është kritikuar kompania kontraktuese. Sipas Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat në Kosovë, kësaj kompanie


private Kuvendi i Kosovës ia paguan 18 mijë euro në muaj, ndërsa 9 000 euro i mbesin fitim kompanisë.

Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat në Kosovë, Jusuf Azemi, ka theksuar se "problemi për pagat e ulëta është te kompania e jo te Kuvendi". Azemi ka shtuar se nëse kjo kërkesë për rritjen e pagave nuk plotësohet, atëherë punëtorët janë të detyruar t'i ndërpresin shërbimet e tyre. "Kuvendi i Kosovës kompanisë i përcjellë 18 mijë euro brenda muajit për shërbimet që i kryejmë.

Problemi është te kompania që i kryen shërbimet. Kuvendi nuk është fajtor e as udhëheqësit e saj. Nëse nuk reflekton pronari i kompanisë, ne sigurisht nga java tjetër, me vendimin e punëtorëve, do t'i ndërpresim shërbimet tona", ka thënë Azemi. Ndërsa përfaqësuesja e punëtorëve teknikë, Nazife Krasniqi, është shprehur se qe gjashtë vjet paguhen nga 275 euro në muaj kurse, sipas saj, për këto vite pagat u janë rritur vetëm dy herë nga 20 euro. (kp)



Shoqata e Bankave të Kosovës: Përfshirja në Google Wallet, vendim individual i bankave



PRISHTINË, 9 KORRIK - Ditë më parë në Kosovë është lansuar aplikacioni Google Wallet, aplikacion ky që shërben për menaxhimin e pagesave. Ai ofron një mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme për të kryer pagesa në internet dhe në dyqane fizike. E aktualisht në Kosovë shërbimin e këtij aplikacioni e ofrojnë vetëm dy banka.

Lidhur me këtë çështje nga Shoqata e Bankave të Kosovës kanë deklaruar për "Telegrafi"-n

se pranimi i Kosovës në Google Wallet sjell përparësi të shumta për klientët dhe bizneset në Kosovë. "Ai lejon pagesa të përshtatshme dhe të menjëhershme në dyqane thjesht duke mbajtur telefonin ose orën e mençur android pranë POS terminalit ku pranohen pagesat pa kontakt. Kjo eliminon nevojën për karta fizike ose para, duke reduktuar rreziqet dhe shqetësimet që lidhen me metodat tradicionale të pagesës",

thuhet në përgjigjen e Shoqatës së Bankave të Kosovës.

Shoqata ka bërë me dije se transaksionet e kryera përmes Google Pay mbrohen nga teknologjia e avancuar e enkriptimit të Googles, duke siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje për të dhënat personale dhe financiare. "Google Wallet i bën pagesat në internet jashtëzakonisht të lehta duke përfunduar transaksionet për vetëm një minutë", kanë

deklaruar nga Shoqata e Bankave të Kosovës.

Sa iu përket bankave në Kosovë, Shoqata ka bërë me dije se përfshirja e tyre në këtë shërbim është një çështje e brendshme e secilës bankë komerciale dhe lidhet me strategjitë e tyre individuale.

"Secila bankë vendos se a do të jetë pjesë e kësaj platforme dhe nëse do t'i bashkohet në të ardhmen. Momentalisht klientët e bankave NLB dhe ProCredit

mund ta përdorin shërbimin Google Pay duke shkarkuar aplikacionin Google Wallet nga Google Play Store dhe ta shtojnë kartën e tyre", kanë deklaruar nga Shoqata e Bankave të Kosovës.

Për ta përdorur shërbimin Google Pay, klientët duhet ta shkarkojnë aplikacionin Google Wallet nga Google Play Store dhe ta shtojnë kartën e tyre Visa. Përdoruesit do të jenë në gjendje t'i shtojnë kartelat e tyre të kreditit apo debitit në Google Wallet.

Shqyrtohet propozimi i amendamenteve për Projektligjin për krypto asetet

PRISHTINË, 9 KORRIK - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, udhëhequr nga Ferat Shala, kryetar, mbajti mbledhjen e rregullt. Në këtë mbledhje anëtarët e komisionit bënë shqyrtimin e propozim-amendamenteve për Projektligjin për krypto asetet.

Më tutje, anëtarët e komisionit u pajtuan që të marrin pjesë si komision në formimin e panelit për zhvillimin e procesit të intervistimit për zgjedhjen e "Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit. Ndërsa me kërkesë të

deputetes Jeta Statovci u bë ndryshim i rendit të ditës, duke larguar dy pika, përkatësisht shqyrtimin e dytë të Projektligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, si dhe shqyrtimin e raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) për vitin 2023.



Për ata që u fshihen të vërtetave të jetës

Nga: Gëzim TUSHI

Sintagma pothuaj me për masë sociale dhe njëkohësisht neverirëse e pëhapur në “eterin social” se “në këtë vend nuk jetohej” apo akoma më keq, justifikimi i epidemisë patologjike të vazhdimit të rrjedhjes së popullsisë dhe largimeve të qytetarëve, në emër të një lloj bindjeje të sipërfaqshme me theks evident ekzibicional, që krijon përshtypjen shumë herë pa shkak e të pajustificuar të mendimit të gabuar se “duhet ikur nga ky vend”, është kthyer në një nga pengesat e mëdha sinkretike e sintetike, që tashmë po kthehet në “pengesë strategjike” që pengon ecjen normale të individit, ritmet e zhvillimit, progresit social dhe ekonomik të shoqërisë.

Mbi të gjitha, kjo sintagmë qarkulluese është përgjegjëse dhe shkak që synon të mbjellë e kultivojë psikologjikisht dhe padrejtësisht në përmasa alogjike, shumë “sëmundje sociale” endemike. Qëndrime aspak realiste, me natyrë të pastër regresive që janë bërë psikovampirë që paralizojnë dhe thithin energjitë pozitive të vendit, kapacitetet e shoqërisë dhe aftësitë e individit për progres personal. Padyshim, urbanizimi i përshtypshëm i jetës në Shqipëri, transformimet radikale që kanë pësuar marrëdhëniet sociale në shoqëri, në mënyrë të natyrshme ka krijuar njerëz të orientuar sakytë e të sukseshëm në jetën e tyre. Por në të njëjtën kohë po shtohen individët, madje deri në shtresa sociale që herë për arsye objektive të situatave që kalon vendi dhe shumë herë për shkak të perceptimeve subjektive, akoma i kanë vendosur vetes “perden sociale”, si instrument okult që i pengon, për të kuptuar të vërtetat e jetës reale dhe jo asaj imagjinare.

E gjithë kjo, për shkak të iluzioneve paralizuese, koncepteve demoralizuese që ata kanë krijuar në kokën e tyre artificialisht, që në përmbajtje dhe formë janë kthyer paradigma frenuese, në psikovampirë të vërtetë. Kohët e fundit në shoqëri ka një klimë sociale toksike, e bombarduar me slogane paralizuese, e inonduar me formula vanitoze dhe pritmëri të kota. Kjo sipas mendimit tim, është një nga shkaqet e shumë problemeve që kemi. Të cilat kohët e fundit i gjejmë të sintetizuara edhe në rezultatet e “Censurit 2023”, (për këtë temë dhe korrelacion social, do flasim një herë tjetër). Këto koncepte, perceptime e sjellje sociale, shfaqen me agresivitet të lartë duke qënë në thelbin e tyre qëndrime negativiste, demotivuese e paralizuese, janë bërë shumë serioze në shoqërinë tonë, e cila po përballet përveçse me vështirësitë e rritjes, ecjes dhe shtimit të

shpejtësisë së lëvizjes, edhe këtë handicap social që ndikohet nga perceptime e pritmëri sociale të deformuara, jo realiste e paralizuese.

Të cilat nuk kanë vetëm efekt masiv psikologjik në klimën e përgjithshme të shoqërisë, por edhe efekte “materiale” serioze, sikurse janë një varg problemesh social demografike që po sjellin plakjen e popullsisë, rënien e lindshmërisë, prishjen e balancave numerike midis brezave, vazhdimin e pandërprerë të emigracionit, zgjerimin e migracionit të brendshëm kaotik, që po “trafshon” fshatra të tëra dhe po zvogëlon në mënyrë dramatike qytetet periferike, duke sjellë “dyndjen” e popullsisë në disa qytete metropolitane, “këmisha urbane” e të cilëve është ngushtuar seriozisht dhe ka rrezik të “shqyhet”.

Në këto kushte, nuk duket krejt alogjike shqetësimi që kanë njerëzit për të sotmen dhe të ardhmen e tyre dhe mundësitë që ajo të garantohet nga zhvillimet normale në këtë vend. Padyshim, vështirësitë ekonomike dhe anomalitë e gjëra sociale të jetës urbane, problemet e punësimit dhe papunësisë, nivelit jo të kënaqshëm të shërbimeve sociale, kulturore e arsimore, niveli i mirëqenies, korrupsionit, kriminalitetit, nepotizmit dhe shumë patologji të tjera, e kanë “trashur” shtresën e njerëzve skeptikë, të padurueshëm apo të kapitulluar, përballë vështirëve qoftë të vërteta e me natyrë objektive apo të perceptuara subjektivisht në trajtë të deformuar. Në rrugët e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë ndeshim çdo ditë njerëz, që janë produkt i “qytetërimit tonë kompleks”, që kanë vanitetin, kotësinë, boshllëkun si sjellje publike. Ata nuk janë një apo dy, madje as disa. Vanitozët, janë kategori sociale, madje janë duke u formatuar si “grup social”. Nga pikëpamja sasiore dhe “cilësore”, ky grup social në rritje. Nga mënyra e jetesës, sjelljes dhe komportimit social, ata dëshmojnë se, vullnetarisht qëndrojnë në periferi të “mekanizmit të dobishëm social”.

Mungesa e funksionimit të shëndoshë, e angazhimit, për të përballuar obligimet individuale, familjare, komunitare dhe sociale, qëndrimi indiferent, në pritmëni, pa aktivitet prej tyre motivohet si e drejtë e njeriut që të zgjedhë mënyrën e jetesës dhe realizimit të “objektivave individuale” dhe modalitetet e sjelljes sociale. Ata janë njerëz pa mision dhe funksion social. Shpërdorimi i të drejtës, për të qënë i lirë, i ekzistencës e mundësive, zgjidhjeve dhe alternativave të shumta, mos angazhimi pozitiv në shfrytëzimin e kushteve sociale, për t’u ingranuar në çdo kohë dhe moshë, në veprimtari të qëllimshme sociale, pavarësisht nga “koha



personale”, që njeriu përdor për të “ndeuzur motorët” individualë të integritetit social kanë sjellë krijimin e njerëzve që shprehen se “duhet ikur nga ky vend”. Ata janë njerëz që qarkullojnë në jetë pa objektiva, as personale, pa le më pastaj të pretendosh, për detyrimet si qenie sociale. Është e vërtetë, shoqëria jonë po përballet me paradokse të hidhur, që janë qesharake në dukje, por edhe shumë problematike në thelbin e tyre, që po kthehen në “paradigma penguese të qytetërimit tonë”, sidomos, të së ardhmes së tij.

Janë në zgjerim disa grupe që kanë ngjashmëri psikosociale vanitoze, që “jetojnë si njerëz në seri”, që kanë sjellje të ngjashme sociale, defekte të përbashkëta. Në rrugë, lokale, ambiente publike ndeshesh me njerëz që “rrotullohen” gjithë ditën si “sommambul”, me ide fantazmagorike të flashkuara, utopike e imagjinare, që qarkullojnë në jetën e tyre me një minimum energjish, të cilat janë të pamjaftueshme, për t’i vënë në lëvizje veten. Sëmundja e “vanitetit social”, e sjelljes kulturore, pa objektiva precize, mendoj se është një nga “plagët” më të mëdha. Vaniteti, kotësia, vërdallosja, mungesa e aftësive të integritetit pragmatist është sipas mendimit tim, një nga dukuritë sociale më masive, si shfaqje, si shtrirje dhe intensitet, që ka kapur një pjesë të shoqërisë. Ato shfaqen në përmasat e sëmundjeve sociale, që nuk janë të lidhura vetëm me moshën, përkatësinë e pozicionit geografik, në të cilin jeton njeriu, apo veçori të tjera.

Vaniteti, filozofimet boshe të njerëzve janë shkak kryesor, që një grup në zgjerim i njerëzve, në moshë të ndryshme, janë në pozicione inproduktive, në role sociale pa vlerë, “në bisht” të shoqërisë. Të tillë janë sot, jo njerëz të veçantë, por sipas mendimit tim, shtresa më të gjëra, pjesë të grupeve sociale që janë të rinj, që nuk studiojnë dhe nuk punojnë, njerëz që kanë gjetur rrugë kriminale, për të plotësuar dëshirat e tyre materiale, përdorues të drogave, alkoolit (të cilët janë duke u shtuar shumë dhe sipas mendimit tim, janë në fazën e kalimit nga “grup social” në “shtresë shoqërore”. Kjo ka infektuar një pjesë të të papunëve, njerëzit e pashpresë.

Nuk është çështje e lehtë, nuk duhet marrë me shaka. Vanitozët,

njerëzit që enden rrugëve, pa objektiva dhe synime, të varfër dhe të paorientuar, sot mund të duken si masa kaotike, që enden në qendër të Tiranës dhe në periferi të saj, në lokalet luksoze të Bllokut, apo rrotull lokaleve periferike, në të cilat organizohen orgji të vërteta alkooli dhe seksi. Kështu mund të duken si “masa njerëzish në seri”, por që në mos sot, nesër do të jenë një “mjet presioni” social, mbi shoqërinë, për të gjetur edhe ata “hisen e tyre”, në këtë shoqëri. Pavarësisht se shumica e fajit dhe e përgjegjësisë është e lidhur me mënyrën vanitoze, të paorientuar të jetës së tyre personale, diçka duhet bërë edhe për këtë shtresë për të dalë nga gropa e pesimizmit dhe e kotësive, sepse edhe ata janë pjesë e shoqërisë, pavarësisht se kanë bërë zgjedhjen e tyre më të keqe, në sistemin e ngatërruar të “mekanizmit social”. Padyshim, ata kanë nevojë të ndryshojnë mentalitetin e pastaj sjelljen sociale. Në fakt, është e udhës që të ndikojmë në perceptimin realist të situatave, vështirësive që kalojmë dhe t’i mësojmë dhe edukojmë njerëzit tanë jo me frymën e pesimizmit dhe vështirimit të realitetit me “optika dështuese”. Koha që jetojmë dhe situatat social ekonomike që përjetojmë nuk janë të lehta. Kalimi i akseluar, shpesh herë pa patur bazamentet material, ekuilibrat e duhura psikologjike dhe emocionale që janë në natyrën postmoderne të shoqërisë “materialiste” dhe “postmaterialiste” që jetojmë, kanë sjellë shumë turbulencë e paqartësi konceptuale për të perceptuar drejt të vërtetat tona. Kjo natyrisht bëhet duke qënë “esëll” dhe jo të “droguar”, nga perceptimet subjektive e të deformuara të realitetit apo dëshirat jo realiste të njerëzve, që janë të prirur për të parë “anën e errët” të jetës, duke nihiluar gjithçka bëhet, arrihet e progresohet.

Padyshim jetojmë kohë të vështira të posttranzicionit dhe kërkesave ultimative e transformuese të adoptimit me koncepte të reja jetësore, për shkak të ndikimit imponues e “imperialist” të jetës postmoderne, e cila për hir të së vërtetës sikurse po duket, nuk është etapë e lehtë. Sidomos për ata që qëndrojnë pasivë, në pozita integralisht mohuese, kritice e subjektive, që nuk duan të përfshihen në vorbullat e jetës së vërtetë, që me përtaci mendore e

fizike ëndërrojnë për një jetë me “sy hapur”. Ata janë njerëz që gabimisht presin ditë e “kohë të qeta” sociale kur të “pushojë stuhia”, në mënyrë që të jenë “gatë” për momentin utopik, kur do mund të krijohen kushtet që do përshtaten me prirjet e tyre, rrethanat sociale për të gjetur hapësirën dhe kohën që ata mendojnë se do jetë më e lehtë, më e përshtatshme që ata të mund të orientohen.

Unë mendoj se kjo shtresë sociale heterogjene nga përbërja moshore e kulturore, është e diversifikuar si strukturë sociale. Por problemi është se ata jo vetëm nuk janë numerikisht pak, por mbi të gjitha efektet “toksike” të sjelljeve individuale paralizuese, janë me ndikime përkeqësuese për ata personalisht në radhë të parë, por edhe për trashjen e “llumit” të vanitetit social, sikurse janë shfaqjet evidente të përtacisë individuale, sjelljeve destruktive në familje, shtimi veseve sociale, përdorimi në zgjerim i drogës, alkoolit, shtimi dhunës, vjedhjeve, përkeqësimit të tregut të punës, nevojave për fuqi punëtore, nxitjen e pamotivuar të emigracionit e plot “nën pasoja” të tjera, që janë derivate të këtyre qëndrimeve e sjelljeve.

Këtyre njerëzve u duhet kultivuar një bindje tjetër. Së pari, është e domosdoshme që në nivele sa më të gjera, ndoshta me të gjitha shtresat sociale të shoqërisë duhet punuar, për të krijuar mentalitet koherent, kompatibël me kohën, jetën e sotme dhe të vërtetat e pandryshuara të saj, duke i larguar nga dëgjimi gabuar, i pamundur që presin më kot apo shpresojnë ata. Sepse është ideologjikisht, materialisht dhe psikologjikisht e sigurt, se nuk besoj se do të vijë ndonjë “kohë tjetër” apo moment historik, që të jetë shoqërisht komod dhe i sigurt, materialisht i qetë, si parakusht që të kënaqë ata që në mënyrë naive kanë “lidhur duart” dhe presin kohën kur mund të ndalet “stuhia e postmodernitetit”.

Ato përkundrazi do forcohen dhe nuk do lënë hapësirë për njeriun që kërkon t’i “fshihet” të vërtetave të jetës apo që mendon se një ditë të pushojë stuhia e ndërlikimeve të jetës postmoderne. Është moment që gjërat t’i themi hapur, në mënyrë që të mos krijohen iluzione sociale paralizuese apo të qarkullojmë ide si “aspirina” për dembelët me energji të paralizuar, nga që nuk kuptojnë as atë që po jetojmë dhe sidomos atë që “po vjen nesër”. Stuhitë e kësaj tipologjie jete që po përjetojmë sot, me shumë individuale, me përgjegjësi të personalizuara, me më pak përgjegjësi sociale, humanizëm e solidaritet, të jeni të sigurt që në të ardhmen do të “fryjnë më fort”, do të ecë me shpejtësi akoma më të mëdha. Për pasojë, është e pamundur të realizohen dëshirat e atyre që kërkojnë që ajo të ndalet. Është e pamundur.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT
EURO2024 GERMANY



Holanda e Anglia në kërkim të finales



FORMACIONET E MUNDSHME:

Holanda: Verbruggen; Dumfries, De Vrij, Van Dijk, Ake; Schouten, Reijnders; Malen, Simons, Gakpo; Depay.
Anglia: Pickford; Walker, Stones, Guehi; Saka, Mainoo, Rice, Trippier; Bellingham, Foden; Kane.

“Epoka e re”

DORTMUND, 9 KORRIK - Sonte (e mërkurë) nga ora 21:00 do të mësohet finalisti i dytë në Kampionatin Evropian “Euro 2024”. Do të takohen Holanda dhe Anglia. Këto dy skuadra të mëdha përfaqësuese kanë pasur mjaft probleme në këtë eveniment duke arritur kualifikimin në gjysmëfinale me mjaft telashe, por tash janë afër të kualifikohen në finalen e madhe që zhvillohet të dielën. “Holanda? Ata lojtarë kanë llojin e tyre të personalitetit, luajnë ashtu siç luajnë dhe kjo nuk do të ndryshojë. Mënyra se si ata luajnë nuk

ndikon në mënyrën se si ne luajmë. Ne duhet të arrijmë në atë nivel që ka Holanda dhe të jemi më të mirë atë natë. Ne jemi të motivuar, kemi një mentalitet ‘kurrë mos vdis dhe vazhdojmë të shtyjmë deri në fund’. Ky është një art më vete, te besosh te forcat e tua”, ka thënë portieri i Anglisë, Jordan Pickford. Anglia do të synojë një finale të dytë radhazi të Evropianit, por për këtë duhet një frymëzim pas paraqitjeve jo bindëse deri tash. “Tre Luanët” arritën në gjysmëfinalen e katërt të Kampionatit Evropian duke e mposhtur Zvicrën në çerekfinalen e javës së kaluar. Zvicra shënoi nëpërmjet Breel Embolo, por

Anglia barazoi në fund të ndeshjes me anë të Bukayo Sakas dhe në penallti ishte më e suksesshme duke siguruar kualifikimin. Në anën tjetër, Holanda kaloi në gjysmëfinale pas mungesës së gjatë prej vitit 2004. Në çerekfinale, holandezët e mposhtën Turqinë me përmbyse 2-1. Për ndeshjen me Anglinë ka folur futbollisti i Holandës, Cody Gakpo. “Është një ndeshje shumë e fortë. Ne jemi në gjysmëfinale tani dhe padyshim që ky nuk është fundi i turneut. Çdo ekip në gjysmëfinale dëshiron të arrijë në finale. Kjo shkon edhe për ne, pra kjo është ambicia jonë”, ka thënë Gakpo.

Sylvinho nuk është më trajner i Shqipërisë

TIRANË, 9 KORRIK - Më 25 qershor Sylvinho erdhi për herë të fundit në Tiranë dhe më pas u largua për pushime, duke njoftuar se do të rikthehej pas një jave për të diskutuar me FShF-në për kontratën e tij, megjithatë kjo gjë nuk ndodhi dhe tashmë klima nuk është më e njëjtë. “Top Channel” raporton se nga sot Sylvinho zyrtarisht nuk është më trajner i Shqipërisë, pasi pikërisht në këtë datë (9 korrik) brazilianit i ka skaduar kontrata me kuqezinjët. Sylvinho refuzoi apo shmangu në disa raste çështjen e rinovimit të kontratës në prag të Evropianit, duke u justifikuar me përgatitjen e eventit, ndërsa më pas nisi pushimet, pasi Kombëtarja shqiptare konsiderohet një “punë e sigurt për trajnerin brazilian”, në pritje se çfarë ofertash



do të vijnë të tjera për t’i konsideruar. Megjithatë në ditët në vazhdim do të mësojmë më tepër nëse Sylvinho gjeti apo jo ekip tjetër, apo do të rikthehet në Tiranë për një tjetër aventurë.

SHKURT

Cagliari kërkon Dakun

Klubi italian Cagliari ka bërë një ofertë në drejtim të Rubin Kazanit për transferimin e sulmuesit shqiptar Mirlind Daku, raporton Match TV. Daku u transferua te Rubini nga klubi kroat Osijek në korrik të vitit 2023. Kontrata e tij me klubin nga Rusia është e vlefshme deri në fund të qershorit të vitit 2026. Sipas informacioneve të Match TV, Rubin Kazani ende nuk ka përgjigje për ofertën e klubit italian. Në sezonin e kaluar, 26-vjeçari luajti 33 ndeshje për Rubinin, në të cilat shënoi 10 gola dhe bëri katër asistime. Sezoni i ri i Premierë Ligës ruse fillon më 20 korrik.

Dukagjini ‘blindon’ portën me Bekim Rexhepin

Skuadra e Dukagjinit nga Klina vazhdon përforcimet. I fundit që iu ka bashkuar skuadrës që do të drejtohet nga Ismet Munishi është portieri Bekim Rexhepi. “Njoftojmë të gjithë komunitetin sportiv dhe publikun e gjerë se kemi arritur marrëveshje me portierin nga Shkupi, Bekim Rexhepi, i cili me përvojën e tij që ka pasur së fundi në kampionatin shqiptar te skuadra e Skënderbeut, Partizanit dhe Dianmos, synon që të bëjë më të mirën edhe në kampionatin kosovar, respektivisht te skuadra jonë”, thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

Qerimi publikon listën e Kosovës U20

Shtabi teknik i Përfaqësueses U20 të Kosovës në hendboll, që udhëhiqet nga selektori Bujar Qerimi, ka publikuar listën finale të lojtarëve të ftuar për Kampionatin Evropian që mbahet në Prishtinë. Kosova U20 ka disa javë që është grumbulluar, por në përbërje më të zgjeruar. Dhe tani është publikuar lista finale për Evropian. Hendbollistët e Kosovës U20 grumbullohen të martën në Prishtinë. I kanë edhe disa ditë në dispozicion për t’u përgatitur për ndeshjen e parë. Evropiani i Divizionit B në Prishtinë mbahet prej 13 deri më 21 korrik. Të shtunën prej orës 19:15, Përfaqësuesja e Kosovës luan ndaj Bullgarisë në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Lista e hendbollistëve: Olt Kabashi, Albios Beqiraj, Granit Kadiri, Etnik Bajoku, Eltion Hoxha, Erion Bajramaj, Bleron Imeraj, Ilir Istrefaj, Edonis Hajra, Olsi Mulaj, Dren Gashi, Diolen Ajvazi, Artin Ahmeti, Amar Muqolli, Përparim Kuqi, Luigj Kolaj, Ardrin Dobraj, Elion Goçi.

Thiago Alcantara, mesazh emocionues pas pensionimit

Thiago Alcantara i ka dhënë fund karrierës si futbollist aktiv. Mesfushori spanjoll i vari këpucët pas përfundimit të këtij sezoni pas një karriere të bujshme. Ai u quajt nga shumëkush si magjik, sepse ajo që ai bënte me topin ishte e jashtëzakonshme. Vetë spanjoll i bëri një postim emocionues pasi njoftoi pensionimin. “Unë gjithmonë do të jem i gatshëm të kthej atë që më është dhënë dhe jam mirënjohës për kohën që e kam shijuar. Faleminderit futbolli! Dhe të gjithë ju që më shoqëruat dhe më bëtë një lojtar dhe person më të mirë gjatë rrugës”, ka shkruar Alcantara në llogarinë zyrtare në “Twitter”.

Strakosha paraqitet tek AEK-u: Nuk ka më fjalë, vetëm punë

ATHINË, 9 KORRIK - Thomas Strakosha është lojtari më i ri i AEK-ut. Ka qenë klubi grek që e ka zyrtarizuar lajmin në rrjetet sociale. Portieri shqiptar, i cili u aktivizua së fundmi te Brentfordi, ka firmosur një kontratë të

vlefshme deri në vitin 2029. "AEK njofton blerjen e Thomas Strakoshës. Portieri shqiptar ka nënshkruar kontratë bashkëpunimi me ekipin tonë deri në qershor të vitit 2029", thuhet në njoftimin e AEK-ut.

29-vjeçari i pati fillimet te Salernitana në Serinë B përpara se të kalonte te Lazio, skuadër në të cilën luajti për disa sezone. Debutimi i Strakoshës, me skuadrën e re në një ndeshje zyrtare, pritet me padurim nga tifozët. "Unë

jam shumë i lumtur që transferimi im tek AEK u kompletua. Po pres me padurim që të nis stërvitjen dhe të jem në gatishmëri të trajnerit tim. Që nga sot nuk ka më fjalë, vetëm punë", ka thënë Strakosha.



Fillon Kampi Nacional i FBK-së

PRIZREN, 9 KORRIK - Zyrtarisht ka filluar Kampi Nacional i Basketbollit, i organizuar nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) në kuadër të projektit Youth Development Fund (YDF). Ky kamp, i cili ka për qëllim zhvillimin e të rinjve, do t'i mbledhë fëmijët e lindur në vitet 2011-2012 dhe do të zhvillohet në ambientet e Gjimnazit Loyola në Prizren, nga data 8 deri më 13 korrik 2024.

Kampi Nacional i këtij viti përfshin një program të gjerë trajnimit, i cili është i dizajnuar për të ndihmuar në zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive basketbollistike të pjesëmarrësve. Fokusi kryesor i trajnimeve do të jetë në teknikat themelore të basketbollit, zhvillimin e aftësive individuale dhe kolektive, si dhe në nxitjen e shpirtit të garës dhe bashkëpunimit ndërmjet



fëmijëve. "Kjo iniciativë ka për qëllim jo vetëm përmirësimin e aftësive teknike, por edhe zhvillimin e vlerave të rëndësishme si disiplina, përkushtimi dhe respekti për sportin dhe shokët e skuadrës. Synimi kryesor i Kampit Nacional është të kontribuojë në formimin e fëmijëve si lojtarë të

ardhshëm potencialë për ekipet kombëtare të Kosovës. Duke i ekspozuar ata ndaj një ambienti profesional dhe trajnimeve intensive, FBK synon t'i identifikojë dhe t'i kultivojë talentet e reja që do të përfaqësojnë vendin në garat ndërkombëtare në të ardhmen", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Hamilton: Triumfi në Silverstone, njësoj sikur të kisha fituar titullin kampion në Formula 1

LONDËR, 9 KORRIK - "Ndjeva diçka fantastike brenda meje, zemra më rrihte fort. Nuk isha ndier kështu për një kohë të gjatë dhe mendoj se ishte një lloj lehtësime që më bëri ta shijoja momentin së bashku me tifozët dhe ekipin tim". Është ky komenti që bën sot piloti britanik Lewis Hamilton, 48 orë nga triumfi në garën e Silverstones, ku ai u rikthye te suksesi pas dy vitesh e gjysmë. Një triumf që erdhi në garën e shtëpisë për 7 herë kampionin e botës në Formula 1. "Është diçka e pabesueshme, një ndjenjë e çmendur, dhe nëse jam i sinqertë, është pothuajse po aq e bukur sa ta fitosh kampionatin botëror. Fitorja e vitit 2008 ishte e vështirë për t'u mposhtur sepse ishte e gjitha në shi. Këtë herë, për shkak të kushteve, rrethanave dhe vendosmërisë që kisha në pistë, ishte diçka më shumë", ka thënë Hamilton.



Më tej, Hamiltoni ka deklaruar: "I jam afruar disa herë fitores në këto vite, por kisha ndjesinë se momenti im nuk do të vinte më kurrë dhe për aspektin emocional kjo është fitorja më e mirë. Kishte një ekuilibër të mirë, por ne ishim gjithmonë të kujdesshëm sepse mjaftonte një gabim për të prishur gjithçka". "Ishte një nga

performancat më të afërta me perfeksionin që kam pasur ndonjëherë. Kishte një moment kur dola jashtë, por kisha një vendosmëri të ashpër. Kisha fitoren në sytë e mi dhe nuk bëra pothuajse asnjë gabim. Sa më shumë afrohej finishi ndjenja ishte gjithnjë e më e bukur", ka shtuar Hamiltoni.

SHKURT

Barça synon transferimin e Olmos

Sulmuesi Dani Olmo është duke shkëlqyer me fanellën e RB Leipzigit në kampionatin gjerman të futbollit, Bundesliga. Kjo ka ndikuar që bordi i Barcelonës ta kthejë në synim kryesor, por deri më tash problem vijon të mbetet klauzola e lojtarit, me drejtuesit e klubit gjerman që kërkojnë jo më pak se 60 milionë euro për ta lënë "fantazistin" të largohet. 25-vjeçari spanjoll i ka njoftuar drejtuesit e Leipzigit dëshirën e tij për të luajtur në "Camp Nou" dhe për këtë arsye presidenti Joan Laporta po bën maksimumin për finalizimin e këtij transferimi.

Unitedi largon Van de Beekun, synon transferimin e Chilwellit

Skuadra e Manchester Unitedit është ende në ndërtim e sipër për sezonin e ri. Pas rikonfirmimit deri në vitin 2026 të trajnerit Erik ten Hag, klubi ka nisur punën për të përgatitur një ekip pretendent. Sipas "Sky Sports", Unitedi do ta largojë mesfushorin Donny van de Beek. 27-vjeçari iu bashkua klubit nga Ajaxi në vitin 2020, por që atëherë ka bërë vetëm 35 paraqitje në Premierë Ligë. Manchester Unitedi ka ulur ndjeshëm pretendimet financiare për lojtarin, i cili kaloi gjysmën e dytë të sezonit të kaluar në huazim tek Eintracht Frankfurti. Pritet që mesfushori holandez të transferohet te skuadra spanjolle Girona. Një tjetër emër i përmendur për të ardhur te skuadra është ai i mbrojtësit të majtë të Chelseat, Ben Chilwell. Klubi mendon se ai do ta shtonte konkurrencën me Luke Shaw, i rikthyer së fundi nga dëmtimi me kombëtaren. Shaw humbi 26 ndeshje në Premierë Ligë sezonin e kaluar, duke përfshirë tre muajt e fundit. Chilwell, 27 vjeç, gjithashtu luajti vetëm 12 ndeshje në kampionat për "blues" në sezonin e fundit.

105 000 tifozë holandezë dhe britanikë për 65 000 vende në stadium për gjysmëfinalen e 'Euro 2024'

Policia e Dortmundit nuk po e klasifikon gjysmëfinalen e "Euro2024" mes Holandës dhe Anglisë si me rrezik të lartë. "Ne presim një ngjarje paqësore. Nuk ka një atmosferë armiqësore midis dy grupeve të tifozëve. Ne parashikojmë një festival të madh dhe plot ngjyra futbollit", ka thënë një zëdhënës e policisë. Megjithatë, masa të veçanta janë ende të nevojshme për shkak të turmës së madhe. Deri në 80 000 tifozë holandezë dhe 25 000 anglezë priten në qytetin perëndimor të Gjermanisë, me vetëm 65 000 me bileta. Parqet e tifozëve në "Friedensplatz" në qytet dhe në "Westfalenpark" pranë stadiumit ka të ngjarë të jenë të mbushura me tifozë që nuk kanë bileta për ndeshjen. Një marshim i planifikuar i tifozëve nga mijëra tifozë holandezë të veshur me portokalli drejt stadiumit, i cili është bërë një nga imazhet më ikonike të këtij turneu në raundet e mëparshme, kërkon gjithashtu veprimin e policisë. "Për shkak të masës së tifozëve, ne do t'i vendosim forcat e duhura", ka thënë zëdhënësja e policisë.

Erdogani sulmon UEFA-n për dënimin ndaj Demiralit: Ky është një ndëshkim për Turqinë

Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka kritikuar UEFA-n për vendimin e saj për ta pezulluar mbrojtësin Merih Demiral për përhëndetjen dhe gjestin e tij të diskutueshëm. Në një deklaratë për agjencinë e lajmeve Anadolu, Erdogan, i cili spontanisht udhëtoi në Gjermani për

çerekfinalen në mes të Holandës dhe Turqisë (2-1), kritikoi UEFA-n për pezullimin e mbrojtësit. Demiral shënoi dy gola për Turqinë në fitoren 2-1 ndaj Austrisë, duke festuar golin e dytë duke ngritur duart lart dhe duke treguar përhëndetjen e Ujqërve Gri, një grup

ultranacionalist turk. Ujqërit gri përfaqësojnë një ideologji që pretendon se raca turke është superiore ndaj të tjerëve dhe përpigjet të bashkohet në një vend nga Ballkani deri në Kinë. Shtëpia më e madhe e futbollit evropian, UEFA, vendosi të jetë strikte me Merih Demiral dhe ta

pezullojë atë për përhëndetjen e të ashtuquajturve "Ujqërit gri" në ndeshjen ndaj Austrisë. Për Erdoganin, ky vendim është "i pashpjegueshëm dhe thjesht politik". "Sinqerisht, ajo hodhi një hije të keqe në Kampionatin Evropian. Në fakt, ky është një ndëshkim për Turqinë si komb

dhe është një vendim i pashpjegueshëm dhe thjesht politik", ka thënë Erdogan. Nga këndvështrimi i tifozëve turq kjo përhëndetje nuk është racizëm, por simbol kombëtar i turqve dhe sigurisht nuk është çudi që ata nuk janë dakord me vendimin e UEFA-s.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X) në Qendrat e Kompetencës për vitin shkollor 2024/2025
Prishtinë, Korrik 2024

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në Gjinnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2024/25, mund të konkurrojnë nxënësit, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.
Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkuruar për regjistrim në klasën e X-të në IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për Gjinnaze dhe IAAP s për vitin shkollor 2024/2025, bëhet më datën 10, 11 dhe 12 korrik 2024 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 13.07.2024. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 15.07.2024. Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkollën e dytë behën në Agjencinë për Arsimi dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë
- Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar (20%) 20 pikë
- Numri i pikëve nga testi (40%) 40 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%), 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksese per gjinnaze dhe shkolla te mesme te mjeksise eshte qe mesatarja e ketyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9), pastaj mesatarja e mesatareve te atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjinnaze dhe shkolla te mesme të mjeksisë është minimumi 40% e pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9) \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.
 $mesatarja \text{ e lëndës (I)} + mesatarja \text{ e lëndës (II)} + mesatarja \text{ e lëndës (III)} + mesatarja \text{ e lëndës (IV)} = 20 \text{ pikë max}$

Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP

- Shëndetësi, Bujqesi, Teknologji Ushqimorë dhe Veterinari:**
Biologji, Kimi, Fizikë Gjuhe shqipe dhe letërsi,
- Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi — Teknologji, PTT:**
Matematikë, Informatikë, Fizikë, Gjuhë Shqipe dhe letërsi
- Ekonomi, Administratë:**
Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi
- Juridik dhe Administratë:**
Gjuhe shqipe dhe letërsi, Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi

- Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:**

Gjuhë shqipe dhe letërsi Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi

- Shkollat Artistike:**

Gjuhë amtare dhe letërsi Edukat qytetare, Art, Muzikë

- Drejtimi pedagogjik - profili bashkëpunëtor muzikor:**

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar;

- Drejtimi instrumental:**

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII); në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI).

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë, duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

2. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- Shkollat e Shëndetësisë – Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)**

$$\frac{mes(Kimi) + mes(Bio \log ji) + mes(Fizikë) + mes(Gjuhë_shqipe)}{4} \geq 4$$

- Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në IAAP

I. Shendetësi, Bujqësi dhe Veterinari

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Shkencat natyrore 50 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Matematikë dhe informatikë 50 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkencat shoqërore 50 | 50 x 0.05 = 2.5 pikë |
| Totali = 40 pikë | |

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi - Teknologji

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë 50 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Shkenca natyrore 50 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkenca shoqërore 50 | 50 x 0.05 = 2.5 pikë |
| Totali = 40 pikë | |

III. Ekonomi

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë 50 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Shkenca shoqërore 50 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkencat natyrore 50 | 50 x 0.05 = 2.5 pikë |
| Totali = 40 pikë | |

IV. Juridik

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Shkencat shoqërore 50 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 50 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkenca natyrore 50 | 50 x 0.05 = 5 pikë |
| Totali = 40 pikë | |

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Shkenca shoqërore 50 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 50 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkenca natyrore 50 | 50 x 0.05 = 2.5 pikë |
| Totali = 40 pikë | |

VI. Shkollat Artistike

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Shkenca shoqërore 50 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 50 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkenca natyrore 50 | 50 x 0.05 = 2.5 pikë |
| Totali = 40 pikë | |

KONKURSI PËR QENDRAT E KOMPETENCËS 2024/25

Mësimi në gjuhën shqipe								
Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralelet	Nr.Nxënësve	Vitet		
Prizren	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit	Dizajn Softweri	2	48	2+1		
			Informatikë	1	24	2+1		
			TIT (Tek. e Informacionit dhe Telekomunikacionit)	1	24	2+1		
			Teknik i sistemeve të TIK	1	24	2+1		
		Makineri, Prodhim dhe Nderimtari	Trafik rrugor	1	24	2+1		
			Mekatronikë	1	24	2+1		
			Teknik i Elektronikës	1	24	2+1		
			Instalues elektrik (mesim dual)	1	24	2+1		
			Automekanik (mësim dual)	2	48	2+1		
			INKU - Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit dhe Ujesjellesit	4	96	2+1		
			Metalpunues/Saldues (mësim dual)	1	24	2+1		
			Teknik i dizajnit grafik	2	48	2+1		
			Arkitekturë	1	24	2+1		
			Teknik i izolimit të ndërtesave	1	24	2+1		
		Arte	Dizajn enterieri	1	24	2+1		
			Dizajn i tekstilit dhe veshjeve	2	48	2+1		
		Gjithsej- Sh. "11Marsi" Gj. shqipe				23	552	2+1
		Mësimi në gjuhën boshnjake						
		Makineri, prodhim dhe ndertimtari	Trafik rrugor	1	24	2+1		
			TIT (Tek. e Informacionit dhe Telekomunikacionit)	1	24	2+1		
		Arte	Dizajn i tekstilit dhe veshjeve	1	24	2+1		
			Gjithsej- Gj. Boshnjake				3	72
		Mësimi në gjuhën turke						
		Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit	TIT (Tek. e Informacionit dhe Telekomunikacionit)	1	24	2+1		
			Gjithsej- Gj. Turke				1	24
		Gjithsej - Qendra e Kompetencës "11 Marsi"				27	648	

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralelet	Nr.Nxënësve	Vitet		
Prishtinë	Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi"	Makineri, prodhim dhe ndertimtari	Dirigimi kompjuterik i makinave	1	24	2+1		
			Metalpunues	1	24	2+1		
			Automekanik	2	48	2+		
			Instalues ujësjesllësi, ngrohje e klimatizim	3	72	2+1		
			Mekatronikë	1	24			
			Trafik rrugor	1	24	2+1		
			Transport rrugor	1	24	2+1		
			Operator i Trafikut Hekurudhor	1	24	2+1		
		Arte	Dizajn i tekstilit dhe veshjeve	2	48	2+1		
			Rrobaqepësi	1	24	2+1		
		Shërbime	Floktari (mesim dual)	1	24	2+1		
			Esteticieent (mesim dual)	1	24	2+1		
		Gjithsej - "Sh. Gjeçovi"				16	376	

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralelet	Nr.Nxënësve	Vitet
Prizren	Qendra e Kompetencës	Ekonomi, administrate dhe juridik	Financa	1	24	2+1
			Nepunes industrie	1	24	2+1
			Marketing	1	24	2+1
			Shërbime ndaj Konsumatorit	1	24	2+1
		Shërbime	Esteticient (mesim dual)	1	24	2+1
			Floktari (mesim dual)	1	24	2+1
		Turizem	Udheheqes i udhetimeve dhe grupeve turistike	1	24	2+1
			Asistent ne zyra informimi dhe agjenci turistike	1	24	2+1

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralelet	Nr.Nxënësve	Vitet
Prizren	Qendra e Kompetencës	Ekonomi, administrate dhe juridik	Financa	1	24	2+1
			Nepunes industrie	1	24	2+1
			Marketing	1	24	2+1
			Shërbime ndaj Konsumatorit	1	24	2+1
		Shërbime	Esteticient (mesim dual)	1	24	2+1
			Floktari (mesim dual)	1	24	2+1
		Turizem	Udheheqes i udhetimeve dhe grupeve turistike	1	24	2+1
			Asistent ne zyra informimi dhe agjenci turistike	1	24	2+1
		Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Asistent në organizimin e ngjarjeve	1	24	2+1
			Teknik i informatikës së biznesit	1	24	2+1
Zhvillues i aplikacioneve softwerike	1		24	2+1		
Teknik i mediave interaktive	1		24	2+1		
Gjithsej - QK - Prizren				12	288	

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralelet	Nr.Nxënësve	Vitet		
Skenderaj	Qendra e Kompetencës	Makineri, prodhim dhe ndertimtari	Ndërtues i konstruksioneve të thata	2	50	2+1		
			Ngjyrepunues, llakpunues					
			Zdrukhëtarë me punë kulmi					
			Llamarinë punues dhe punues metali					
			Arkitekturë	1			25	2+1
			Instalues i ujit e kanalizimit dhe ngrohje e klimatizim-IUK-NK	2			50	
			Instalues elektrik	1			25	
			Muratorë dhe punëtorë të ngjashëm (mesim dual)	1			25	
		Art	Dizajn i tekstilit dhe veshjeve	1	25	2+1		
			Gjithsej- QK - Skenderaj				8	200

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	Paralelet	Nr.Nxënësve	Vitet
Malishevë	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi"	Ekonomi, administrate dhe juridik	Administratë dhe shërbime të zyrës	2	48	2+1
			Banka dhe sigurime	1	24	2+1
			Shitje dhe Marketing	2	48	
			Tregti me shumice dhe pakice	1	24	
		Shërbime	Hoteleri dhe turizem	1	24	2+1
			Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Teknik i sistemeve të TIK-ut	1	24
		Makineri, prodhim dhe ndertimtari		Instalues elektrik	1	24
			Instalues ujësjesllësi, ngrohje dhe klimatizimit	1	24	
		Art	Dizajn i tekstilit dhe veshjeve	1	24	2+1
			Gjithsej- QK - "Kujtim Krasniqi" Malishevë			

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralelet	Nr.Nxënësve	Vitet			
Ferizaj	Qendra e Kompetencës	Shëndeti dhe mireqenia	Bahkëpunëtorë profesional i infermierisë	1	24	2+1			
			Asistent i Fizioterapisë	1	24	2+1			
			Asistent Dentar	1	24	2+1			
			Teknik i Farmacisë	1	24	2+1			
			Teknik i Optikës	1	24	2+1			
			Asistent i sigurisë ushqimore dhe dietave	1	24	2+1			
			Teknik laborant mjekësor	1	24	2+1			
			Gjithsej - QK - Ferizaj				7	168	2+1

MEKA

 HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992





ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909

RC cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L